

VENDIM
« Për Sekuestrim Pasurie »

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, e përbërë prej

GJYQTAR: Bardhyl DHAMA

Asistuar nga sekretare seance **Ermira Terbuni**, sot në datë 07.10.2010, ora 10.30, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale Nr. 16 Rregj. me:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokuror Adnan Xholi**.

KUNDËR :

SHTETASVE NËN HETIM :

1. **A.P**, lindur dhe banues në XXX, Brindisi-Itali, me kombësi e shtetësi italiane.
2. **E.GJ**, banues në Tiranë, Njësia Bashkiake nrX Rruga XXXX, me kombësi e shtetësi shqiptare.

PERSONAVE TË TRETË: 1.**V.K**, banues ne Vlore.

2.**F.F**, lindur dhe banues ne Itali, me dokument identifikimi AXXX88.

3.**G.P**, lindur dhe banues Itali, me dokument identifikimi AXXX319.

4.**G.B**, banues ne Rruga: XXX, Tirane.

OBJEKTI i KERKESES: Sekuestrimi i pasurive:

1-Aktivitetit të shoqërisë anonime “**XXX**”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqëri në Shqipëri, shoqëri e cila është regjistruar me datë 03/12/2008, me numër

NIPTI KXXXXX5U, me datë themelimi 01/12/2008, me adresë në Tiranë, rruga XXXX, me kapital fillestar 20.000.000 lekë, me objekt “Organizimin e lojërave të fatit sportive-baste sportive”, sipas së cilave;

- 1- i hetuari A.P, zotëron numrin e Aksioneve “900,00”, Përqindjen në kapital “45,00” dhe Kontributi në para “900.000,00”.
- 2- Shtetasi V.K (si person i lidhur me A.P), zotëron numrin e aksioneve “100”, përqindja në kapital 5, kontributi në para 100.000.
- 3- Shtetasi F.F (si person i lidhur me A.P), zotëron numrin e aksioneve “900”, përqindja në kapital 45, kontributi në para 900.000.
- 4- Shtetasi G.P(si person i lidhur me A.P), zotëron numrin e aksioneve “100”, përqindja në kapital 5, kontributi në para 100.000.

2- Aktivitetit të shoqërisë anonime “XXXXXX”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqëri në Shqipëri, shoqëri e cila është regjistruar me datë 26/02/2010, me numër NIPTI LXXXX01B, me datë themelimi 11/02/2010, me adresë në Vlorë, me kapital fillestar 10.000.000 lekë, me objekt: “Administrimi i agjencive për mbledhjen dhe transmetimin e të dhënave me ndihmën e sistemeve informatike dhe të telekomunikacionit, të lidhura ngushtë me prenotimet dhe kontabilizimin të lojërave me ngjarje sportive dhe josportive, subjekte të monopolit të shtetit shqiptar apo të institucioneve të tjera publike shqiptare, të autorizuar për t’u regjistruar në Shqipëri në bazë të ligjeve në fuqi dhe të atyre që do të dalin në të ardhmen në këtë fushë. Administrimin e agjencive për baste të çdo lloji e tipi. Administrimin e llotarive të çastit me çmime dhe llotari fati të mundshme të çdo lloji e tipi. Regjistrim i ngjarjeve sportive në bazë të dispozitave që rregullojnë marrjen e licensave dhe autorizimeve në këtë fushë. Hapjen e sallave sportive në formë live-administrimi i sallave për lojëra, kazino elektronike apo live me ndihmën e operatorit etj”. Në këtë shoqëri, i hetuari A.P është aksioner i saj, i cili zotëron 50 kontribute dhe 50 përqind të pjesëmarrjes. (statusi Aktiv).

3- Aktivitetit të shoqërisë anonime “XXXXXX”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqërie në Shqipëri, shoqëri e cila është regjistruar me datë 01/03/2010, me numër NIPTI L0XXXX14D, me datë themelimi 12/02/2010, me kohëzgjatje deri me 12/02/2060, me Seli në Tiranë, me kapital fillestar 20.000.000 lekë, me objekt

“Sherbime në software, nëpërmjet internetit, për parashikimin e zhvillimit të lojërave të fatit, të kazinove, basteve, garave të ndryshme të të gjitha llojeve, prodhim i materialeve, lëndëve të para dhe prodhim i makinave elektronike të lojërave të fatit. Zhvillim i lojërave të fatit, lojrat aritmetike, lotot, keno, bingo, proto, xhoker, baste, llotari, lojera elektronike, lojëra fati sportive të cilat janë, konkurs për parashikimet sportive të të gjitha lojrave sportive si ato që luhen me këmbë, me dorë, në ujë, për gjetjen e rezultateve, të ndeshjeve të futbollit, ose lojërave të tjera sportive të të gjitha llojeve, kazino”. Sipas ndryshimeve të bëra me datë 05/10/2010, ku vlera e kapitalit ishte (“2.000.000.00”) u be (“20.000.000.00”) dhe vlera e aksionit ishte (“2.000.000.00”) u be (“20.000.000.00”). Në këtë shoqëri;

- 5- I hetuari E.GJ, ka numrin e Aksioneve “50,00”, Përqindjen në kapital “50,00” dhe Kontributi në para “10.000.000,00”. (statusi Aktiv)
- 6- Shtetasi G.P (si person i lidhur me A.P dhe E.GJ), zotëron numrin e aksioneve “30,00”, Përqindja në kapital “30,00”, Kontributi në para 600.000.00”
- 7- Shtetasi G.B (si person i lidhur me A.P dhe E.GJ), zotëron numrin e aksioneve “20,00”, Përqindja në kapital “20,00”, Kontributi në para 4.000.000.00”.

- Për administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të ngarkohet **z.SH.N**, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen Zyra e Permbarimit të vendodhjes së këtyre pasurive.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Në përfundim të gjykimit gjykata, pasi e gjeti veten kompetente për të gjykuar dhe vendosur mbi kërkesën e paraqitur, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit

nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”; pasi dëgjoi pretendimin përfundimtar të prokurorit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj,

V Ë R E N

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë 01.10.2010 dhe ne date 05.10.2010, ka rregjistruar procedimin pasuror nr. 20 akti, në ngarkim të shtetasve nën hetim: 1) **A.P**, *lindur dhe banues në XXX Brindisi-Itali, me kombësi e shtetësi italiane* ; 2) **A.P**, *lindur dhe banues në XXXX, Brindisi-Itali, me kombësi e shtetësi italiane* ; 3) **E.GJ**, *banues në Tiranë, , Rruga « XXXXXX », me kombësi e shtetësi shqiptare dhe persona te lidhur me ta, V.K banues ne Rrugen” XXXX”- Vlore,*

F.F XXX, *nenshtetas Italian,G.P, nenshtetas Italian* .

Ky procedim ka filluar mbi bazen e materialit të dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas te cilit ekzistonin dyshime se shtetasit e mësipërm dispononin aktivitete dhe pasuri të luajtshme e të paluajtshme në qytete te ndryshme te Shqiperise. Nga këto akte rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, më datë 01/10/2010, ka regjistruar procedimin penal nr.XXX, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit italian A.P. Në vazhdim të veprimeve hetimore të kryera rezulton se, më datë 05/10/2010, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka regjistruar dhe emrin e shtetasit italian A.P, si dhe emrin e shtetasit shqiptar E.GJ, në regjistrin e veprave penale, te hetuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga studimi i këtyre materialeve ka rezultuar se, në datën 29/09/2010, ora 04:00 është bërë ekzekutimi i urdhërit të arrestit ndërkombëtar nr.XXXXXX, datë 20/09/2010, të lëshuar nga Prokuroria e XXX, në Itali, për shtetasin italian A.P. Nga aktet e përcjella nga autoritetet italiane, në mbështetje të kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike, rezulton se shtetasi A.P është person i dyshuar nga autoritetet gjyqësore italiane për kryerjen e veprave penale të “Pjesëmarrjes në organizatë kriminale e tipit mafioz”, ”Trafikimit të lëndëve narkotike” dhe “Grabitje në rrethana rënduese” të parashikuara nga seksioni 416 BIS C I-II-III-IV-V, SEKSIONI 74 DPR

309/90, Nenet 110, 629 CO1 dhe 2, nenet 628 CO2, nr.3 të Kodit Penal Italian. Ekzekutimi i këtij urdhëri arresti ndërkombëtar është bërë në ambientet e banesës së tij në Vlorë, pasi disponon kontratë qeraja në emër të bashkëshortes së tij të quajtur A.G.R. Në kërkesën për ndihmë të ndërsjellë juridike që autoritetet italiane kanë dërguar pranë Prokurorisë së Përgjithshme Shqiptare, me N./10 Reg.Rog. N.3695/07, rezulton se të dhënat mbi shkeljet ligjore, mod.21, shtetasi nën hetim A.P, (lindur në XXX (Br), dhe banues në Rrugen: XXXXX), është i hetuar për shkeljet ligjore sipas art.a/416 bis op. 74, DPR 309/90, 110, 629/1.1, vepra penale këto të kryera në zonën e Mesanje, Brindisi, Itali, që nga viti 2007 e më pas.

Nga sa u parashtrua më sipër, gjykata çmon se shtetasit A.P, A.P, E.GJ, janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, sipas nenit 3/1 pika «d», pasi nga autoritetet shqiptare (Prokuroria e Rrethit Gjyqësor - Vlorë), ndaj tyre ka filluar procedimi penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar si e tillë në nenin **287 të Kodit Penal Shqiptar**.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkalles së Parë për Krime të Rënda Tiranë, pas regjistrimit të procedimit pasuror ka kryer verifikimet e nevojshme në lidhje me zbulimin, identifikimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, aktivitetet ekonomike e tregtare të hetuarve **A.P, A.P, E.GJ**, si dhe personave të lidhur me to, në zbatim të nenit 3/2 gjerat “a”, “b” të ligjit nr.10192, datë 03/12/2009. Në këto kushte, prokuroria ka paraqitur kërkesën për sekuestrimin e pasurive, të cilat kanë rezultuar në zotërim të shtetasve në hetim A.P, A.P dhe E.GJ, si dhe personave të tretë, të lidhur me to.

Gjykata, në respektim të kërkesave të nenit 12 pika 1 të ligjit në fjalë, brenda afatit ligjor pesë ditor të parashikuar në këtë dispozitë, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e paraqitur. Në këtë kërkesë dhe në seancë gjyqësore prokurori pretendoi se nga veprimet hetimore të kryera deri më tani janë identifikuar disa aktivitete ekonomike e tregtare, të cilat janë në zotërim të personave në hetim ose të personave të tjerë të afërm e të lidhur me to.

1. Nga aktet e paraqitura në mbështetje të kësaj kërkesë rezulton se, sipas “procesverbalit për kqyrjen dhe marrjen e provave materiale” të datës 04/10/2010,

pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, QKR-së, Tiranë, pikërisht në regjistrin tregtar të titulluar “Gjendja e Regjistrimit”, figuron e regjistruar shoqëria anonime “XXXX”, me të dhënat e mëposhtme: numër NIPTI KXXXXXX5U, me datë regjistrimi 03/12/2008, datë themelimi 01/12/2008, me adresë në Tiranë. Kjo shoqëri ka të deklaruar një kapital fillestar prej 20.000.000 lekë, me objekt “Organizimin e lojërave të fatit sportive-baste sportive”. Në këtë shoqëri rezulton se,

- 8- I hetuari **A.P** është aksioner i kësaj shoqërie i cili zotëron numrin e asioneve “900,00”, përqindjen në kapital “45,00” dhe kontributi në para “900.000,00”.
- 9- Shtetasi V.K (si person i lidhur me të hetuarin **A.P**), zotëron numrin e aksioneve “100”, përqindja në kapital “5”, kontributi në para “100.000”.
- 10- Shtetasi F.F (si person i lidhur me **A.P**), zotëron numrin e aksioneve “900”, përqindja në kapital “45”, kontributi ne para “900.000”.
- 11- Shtetasi G.P (si person i lidhur me A.P), zotëron numrin e aksioneve “100”, përqindja në kapital “5”, kontributi në para “100.000”.

Sipas rubrikës “Historiku i regjistrimit” rezulton se, nga data e regjistrimit 03/12/2008, kanë ndodhur një sërë ndryshimesh, ku mes të tjerave veçohen veprimet e kryera mes ortakëve të ndryshëm në datë 15/10/2009, tek ortakët individ:

është larguar ortakë: (D.S),

është larguar ortakë: (R.H),

është larguar ortakë: (L.S),

është shtuar ortakë: (V.K), numri i aksioneve ‘100’, përqindja në kapital ‘5’, kontributi në para 100.000.

është shtuar ortakë: (F.F), numri i aksioneve 900’, përqindja në kapital ‘45’, kontributi ne para ‘900.000’.

është shtuar ortakë: (**A.P**), numri i aksioneve ‘900’, përqindja në kapital ‘45’, kontributi në para ‘900.000’.

është shtuar ortakë: (G.P), numri i aksioneve ‘100’, përqindja në kapital ‘5’, kontributi në para ‘100.000’.

2. Sipas “Procesverbalit per kqyrjen dhe marrjen e provave materiale”, të datës 04/10/2010, ka rezultuar se pranë QKR-së, Tiranë, në regjistrin tregtar të titulluar “Gjendja e regjistrimit”, figuron e regjistruar edhe shoqëria anonime “XXXXX”, me të dhënat e mëposhtme: numër NIPTI LXXX1B, me datë regjistrimi 26/02/2010, me datë themelimi 11/02/2010, me adresë në Vlorë, me kapital fillestar 10.000.000 lekë dhe me objekt; “Administrimi i agjencive për mbledhjen dhe transmetimin e të dhënave me ndihmën e sistemeve informatike dhe të telekomunikacionit, të lidhura ngushtë me prenotimet dhe kontabilizimin e lojërave, me ngjarje sportive dhe josportive, subjekte të monopolit të shtetit shqiptar apo të institucioneve të tjera publike shqiptare, të autorizuara për t’u regjistruar në Shqipëri në bazë të ligjeve në fuqi dhe të atyre që do të dalin në të ardhmen në këtë fushë. Administrimin e agjensive për baste të çdo lloji e tipi. Administrimin e llotarive të çastit me çmime dhe llotari fati të mundshme të çdo lloji e tipi. Regjistrim i ngjarjeve sportive në bazë të dispozitave që rregullojnë marrjen e licensave dhe autorizimeve në këtë fushë. Hapjen e sallave sportive në formë live-administrimi i sallave për lojra, kazino elektronike apo live me ndihmën e operatorit etj”. Sipas verifikimeve të kryera në lidhje me këtë aktivitet tregtar rezulton se, i hetuari **A.P**, zotëron 50 kontribute dhe 50 përqind të pjesëmarrjes. (statusi Aktiv)

Sipas rubrikës së “Historikut te regjistrimit” të kësaj shoqërie anonime rezulton se, nga data e regjistrimit të saj 26/02/2010, kanë ndodhur disa ndryshime me ‘Adresat e Aktivitetit’:

-Me datë 16/06/2010, është shtuar adresa: (“Tirane, XXXX”)

-Me datë 04/10/2010, është hequr adresa: (“Tirane, XXXXX”)

3. Sipas “Procesverbalit për kqyrjen dhe marrjen e provave materiale”, të datës 05/10/2010, ka rezultuar se pranë QKR-së, Tiranë, në regjistrin tregtar të titulluar “Gjendja e Regjistrimit”, figuron e regjistruar shoqëria anonime “XXXXXX”, me numër NIPTI LXXXX4D, me datë regjistrimi 01/03/2010, me datë themelimi 12/02/2010, me kohëzgjatje deri me 12/02/2060, me seli në Tiranë, me kapital fillestar 20.000.000 lekë, me objekt: “Shërbime në software, nëpërmjet internetit, për parashikimin e zhvillimit të lojërave të fatit, të kazinove, basteve, garave të ndryshme të të gjitha llojeve. Prodhim i materialeve, lëndëve të para dhe

prodhim i makinave elektronike të lojërave të fatit. Zhvillim i lojërave të fatit, lojërat aritmetike, lotot, keno, bingo, proto, xhoker, baste, llotari, lojëra elektronike, lojëra fati sportive, të cilat janë, konkurs për parashikimet sportive të të gjitha lojërave sportive si ato që luhen me këmbë, me dorë, në ujë, për gjetjen e rezultateve të ndeshjeve të futbollit, ose lojërave të tjera sportive të të gjitha llojeve, kazino”. (statusi i pezulluar).

Nga verifikimet e kryera në këtë shoqëri anonime rezulton se, i hetuari E.GJ, ka numrin e aksioneve “50,00”, përqindjen në kapital “50,00” dhe kontributi në para “1.000.000,00”; ndërsa shtetasi G.P (si person i lidhur me **A.P**), zotëron numrin e aksioneve “30,00”, përqindja në kapital “30,00”, kontributi në para 600.000.00”; dhe së fundmi shtetasi G.B (si person i lidhur me E.GJ dhe **A.P**), zotëron numrin e aksioneve “20,00”, përqindja në kapital “20,00”, kontributi në para 400.000.00”.

Sipas rubrikës “Historiku i regjistrimit”, rezulton se edhe më këtë shoqëri anonime kanë ndodhur disa ndryshime që nga data e regjistrimit të saj 01/03/2010, mes ortakëve dhe më konkretisht:

-Me datë 01/10/2010, kanë ndryshuar të dhënat për: E.GJ, numri i aksioneve ishte “20.00” është bërë “50.00”, përqindja në kapital ishte “20.00” dhe është bërë “50.00”, kontributi në para ishte “40.000.00” dhe është bërë “1.00.000.00”;

-është larguar ortaku: **A.P**

-është shtuar ortaku: G.P, numri i aksioneve “30,00”, përqindja në kapital “30,00”, kontributi në para 600.000.00”

-është shtuar ortaku: G.B, numri i aksioneve “20,00”, përqindja në kapital “20,00”, kontributi në para 400.000.00”

-Me datë 05/10/2010, kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme;

-Vlera e kapitalit ishte “2.000.000.00” u bë “20.000.000.00”.

-Vlera e aksionit ishte “2.000.000.00” u bë “20.000.000.00”.

Në të njëjtën datë 05/10/2010, kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme edhe në kontributet e ortakëve të rinj dhe më konkretisht:

-kanë ndryshuar të dhënat për: ortakun G.P, kontributi i të cilit në para ishte “600.000.00” është bërë “6.000.000.00”,

-kanë ndryshuar të dhënat edhe për ortakun G.B, kontributi i të cilit në para ishte “ 400.000.00” dhe është bërë “4.000.000.00”,

-kanë ndryshuar të dhënat për shtetasin E.GJ, kontributi në para i të cilit ka qënë në vlerën “ 1.000.000.00” dhe është bërë “10.000.000.00”.

Kërkuesi, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, pretendoi se, meqenese nga hetimi pasuror ka rezultuar se të hetuarit **A.P**, E.GJ, si dhe personat e lidhur me to V.K, F.F, G.P dhe G.B janë subjekte të ligjit nr.10192 datë 03/12/2009, pasuritë e tyre duhet t’i nënshtrohen procedurës së sekuestrimit sipas ligjit të mësipërm bazuar në nenet 3, 5, 6, 8, 9 e vijues të Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009. Njëkohësisht, prokurori në seancë theksoi se nisur nga fakti që pasuritë e listuara më lart figurojnë të regjistruara në emrin e të hetuarve dhe personave të lidhur me to (ortakë dhe familjarë të tyre), të cilët janë në gjendje të lirë, ekziston rreziku real dhe potencial që pasuritë e mesiperme të tjetërsohen, apo të humbasin (neni 11/1, pikat “a” dhe “b”). Prokuroria pretendon se duhet vendosur masa e sekuestrimit mbi këto pasuri, pasi rezulton e provuar se ato janë krijuar pas vitit 2007, kur është provuar se ka filluar aktiviteti kriminal i të hetuarit A.P, i lidhur ky edhe me të hetuarit e tjerë **A.P** dhe E.GJ, për të cilët dyshohet se kanë konsumuar veprën penale të “ Pastrimit të produkteve të veprës penale”. Organi i akuzës kërkon sekuestrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të drejtat dhe aktivitetet e tyre, pasi ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme se këto pasuri janë krijuar *pas* dhe *gjatë* periudhës së përfshirjes së të hetuarve në veprimtari kriminale, sipas nenit 3/1 gërma “d” të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”. Sipas prokurorisë të hetuarit dhe familjarët e tyre, nuk disponojnë të ardhura të ligjshme, që të justifikojnë blerjen e këtyre pasurive, por këto pasuri janë krijuar si rezultat i aktivitetit të paligjshëm në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale.

Gjykata, në analizë të pretendimeve të parashtruara nga Prokuroria për Krime të Rënda Tranë, si dhe provave të paraqitura prej tij, çmon se kërkesa e paraqitur është e drejtë, e bazuar ligj dhe prova dhe si e tillë duhet të pranohet për këto arsye:

I. Kërkesa është paraqitur në zbatim të nenit 3 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit

nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të titulluar “Fusha e zbatimit”. Sipas pikës 1 të këtij neni, ligji gjen zbatim për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicje për kryerjen prej tyre të një sërë veprash penale, në të cilat përfshihet edhe vepra penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (gërma “d”, pika 1, neni 3 i këtij ligji). U provua në gjykim se ndaj shtetasve **A.P** dhe E.GJ, kanë filluar hetimet për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, për të cilën është duke proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga aktet e paraqitura në mbështetje të kësaj kërkesë, rezulton se aktiviteti tregtar i personave nën hetim ka filluar në vitin 2008, pikërisht pas fillimit të procedimit penal nga autoritet italiane ndaj shtetasit **A.P**. Në verifikim të akteve që shoqërojnë regjistrimin e tre shoqërive anonime, vërehet se të hetuarit **A.P** dhe E.GJ, kanë kryer disa veprime tregtare, duke tentuar të shmangin sekuestrimin e pasurive dhe të drejtave të tjera mbi to. Menjëherë pas arrestimit të shtetasit të dyshuar **A.P**, në zbatim të urdhër arrestit ndërkombëtar, të lëshuar nga autoritet gjyqësore italiane, të hetuarit **A.P** dhe E.GJ, kanë kryer disa ‘shitje-blerje’ të aksioneve të tyre, mes njëri-tjetrit dhe me personat e tretë në këtë gjykim, veprime këto të cilat në çmimin e kësaj gjykate janë indicie të rëndësishme, të cilat justifikojnë dyshimin e arsyeshëm se personat nën hetim janë përfshirë në aktivitetin kriminal të pastrimit të produkteve të veprave penale. Nga ana tjetër, gjykata konstaton se menjëherë pas ekzekutimit të urdher arrestit ndërkombëtar ndaj shtetasit **A.P**, djali i tij, i hetuari **A.P** i ka kaluar aksionet e tij të hetuarit tjetër Ervis Gjeçaj, i cili ka rritur në këtë mënyrë edhe vlerën e kontributit të tij në shoqëritë anonime, fakte të cilat u analizuan më lart. Këto veprime rezulton të jenë kryer në datë 01/10/2010, ku vlera e aksioneve dhe e kontributeve ka qënë për të hetuarin E.GJ ‘1.000.000’ lekë, ndërkohë që vetëm disa ditë më vonë, në datë 05/10/2010, ky kontribut është rritur në vlerën ‘10.000.000’ lekë (dhjetefishuar). Këto veprime rezulton të jenë kryer edhe për dy ortakët e tjerë G.P dhe G.B, të cilët janë bërë pjesë e shoqërive pikërisht në datën 01/10/2010, ndërkohë që në datë 05/10/2010 kontributi i tyre i rritur është në vlerat respektive 6.000.000 lekë dhe 4.000.000 lekë.

Ndryshimi i vlerës së aksioneve në këto shoqëri anonime, brenda pak ditëve nga arrestimi i të dyshuarit **A.P**, jo vetëm që krijon dyshime për ligjshmërinë e këtyre aktiviteteve, por nga ana tjetër, kjo rritje e të ardhurave dhe e vlerës së aksioneve,

dukshëm nuk i përgjigjet nivelit të kapitalit fillestar të deklaruar prej tyre në momentin e regjistrimit të secilës shoqëri anonime.

Sipas pikës 2 gërma “a” të nenit 3, ligji nr.10192, datë 03/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, zbatohet edhe për pasuritë e personave të afërm të subjekteve të pikës 1 të këtij neni. Shtetasi **A.P** është i afërm i të dyshuarit për aktivitet kriminal “mafioz” në Itali, **A.P**, (djali i tij), por njëkohësisht ai së bashku me shtetasin tjetër nën hetim E.GJ, janë persona nën hetim për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, veprë kjo e përfshirë në rrethin e veprave penale për të cilat bën fjalë pika 1 e ligjit në fjalë.

Ndërsa personat e tretë, shtetasit V.K, F.F, G.P dhe G.B, janë subjekte të këtij ligji sipas pikës 2, gërma ‘b’, të nenit 3 të ligjit nr.10192, datë 03/12/2009, pasi nga të dhënat e verifikuara rezulton se pasuritë e personave të tretë dhe përfshirja e tyre si ortakë në shoqëritë anonime të përmendura më lart, *ose* zotërohen nga shtetasit nën hetim **A.P** dhe E.GJ, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë, *ose* kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarisë së paligjshme nga ana e tyre. Përfshirja e tyre në veprimet tregtare të analizuara më lart, ka ndikuar në fshehjen e prejardhjes së pasurisë, por edhe në vështirësimin e konfiskimit të këtyre veprimtarive ekonomike e tregtare, në të ardhmen.

II. Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të ligjit, gjykata çmon se për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë është e domosdoshme ekzistenca njëkohësisht e dy kritereve të përgjithshme që kanë të bëjnë me:

i. Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicje, të cilat tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale,

ii. Zotërimin e pasurive dhe të ardhurave që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, *si dhe* ekzistencën e të paktës njërit prej kushteve të veçanta të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

Neni 11 i ligjit nr. 10192, datë 03/12/2010, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,

parashikon: “Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në indicie që tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruar dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur:

a)ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji;

b)ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale”.

Përsa më sipër u arsyetua se, mbi shtetasit **A.P** dhe E.GJ rëndon dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicjet e analizuar më lart, për përfshirjen e tyre në veprimtarinë kriminale të pastrimit të parave, (për të cilën është duke u hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë), që mund të jenë produkte të veprimtarisë kriminale të te arrestuarit A.P, për të cilin ka filluar procedimi penal që nga viti 2007, nga Prokuroria e XXX, Itali. Këto të dhëna dhe provat e paraqitura nga ana e organit të akuzës, në vlerësimin e gjykatës justifikojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për përfshirjen e tyre në aktivitete kriminale. Në këto rrethana gjykata çmon se, nga aktet e përfshira në fashikujt e gjykimit të kësaj kërkesë, arrihet në konkluzionin se pasuria objekt gjykimi është produkt i veprimtarisë së paligjshme të **A.P**, për sa kohë rezultojnë që është krijuar pas fillimit të kësaj veprimtarie, pas vitit 2007 sipas akteve të përcjella me anë të letërporosisë nga autoritetet italiane. (kriteri 1 i përgjithshëm).

Shtetasit në hetim **A.P** dhe E.GJ, nuk rezultojnë nga aktet bashkangjitur kërkesës, që të kenë të regjistruar ndonjë aktivitet tregëtar apo ndonjë të ardhur tjetër të ligjshme, që të mund të justifikojnë shumat e madhe të parave të qarkulluara prej tyre, në shit-blerjen e aksioneve, gjatë periudhës nga data 1 tetor 2010 deri më 5 tetor 2010 (pra brenda 5 ditëve). Nga të dhënat e marra pranë QKR-së, shtetasit nën hetim nuk figurojnë në ndonjë aktivitet tjetër të ligjshëm para vitit 2008 dhe 2010. Dy nga shoqëritë anonime janë krijuar pikërisht në fillim të vitit 2010 (26 shkurt e 1 mars), me kapital fillestar prej 10.000.000 lekësh shoqëria anonime “XXXX” dhe me

kapital prej 20.000.000 lekësh shoqëria anonime “XXXX”. Në të tre shoqëritë anonime, objekt të këtij gjykimi për sekuestrim, figuron si njëri nga ortakët kryesorë shtetasi nën hetim **A.P**, djali i të arrestuarit **A.P**. Asnjë nga provat e shqyrtuara në këtë proces nuk justifikojnë nivelin e të ardhurave të disponuara nga shtetasi nën hetim **A.P**. Gjykata çmon se ka një lidhje logjike e kohore, mes fillimit të procedimit penal nga autoritetet italiane në ngarkim të të arrestuarit **A.P** dhe fillimit të veprimtarisë tregtare në territorin e shtetit shqiptar, pikërisht me shoqërinë anonime “XXXX”, ku pjesën më të madhe të aksioneve e disponon pikërisht djali i tij, i hetuari për pastrim të parave apo produkteve të veprave penale, **A.P**. Gjykata çmon se veprimet e kryera menjëherë pas arrestimit të të dyshuarit **A.P**, mes shtetasit **A.P** dhe të hetuarit tjetër E.GJ, të përmendura më lart imtësisht, krijojnë dyshime të arsyeshme se edhe ky i fundit është përfshirë në këtë aktivitet kriminale të pastrimit të parave (kriteri 2 i përgjithshëm).

Përveç kriterëve të përgjithshme të analizuar më lart, gjykata çmon se ekziston edhe njëri nga kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 11 të ligjit nr.10192, datë 03/12/2009, pikërisht në gjermën “a”: rreziku real për tjetërsimin e pasurive, të luajtshme dhe të paluajtshme. Ky konkluzion i gjykatës mbështetet në të dhënat e verifikuara nga prokuroria, ku rezulton se pasi shtetasi në hetim Angelo Prudentino, në bashkëpunim me të hetuarin tjetër E.GJ, erdhën në dijeni të arrestimit të shtetasit A.P (babai i të hetuarit A), kanë kryer disa veprime juridike, duke kaluar aksionet tek të tretët e në vazhdim duke rritur dukshëm vlerën e tyre, për të justifikuar pasuritë e disponuara. Në këto kushte, krijohet dyshimi i mbështetur në fakte e prova se, të gjitha këto përpjekje për t’i tjetërsuar pasuritë e disponuara, brenda një kohe të shkurtër, bëhen me qëllim shmangien nga një konfiskim i mundshëm i tyre dhe nxjerrjen e përfitimeve nga pastrimi i produkteve të aktiviteteve kriminale të të arrestuarit për llogari të autoriteteve gjyqësore italiane, **A.P** (kriteri i veçantë i parashikuar në pikën “a” të nenit 11 të këtij ligji).

Në bazë pikës 2 të nenit 14 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, ekziston detyrimi që gjykata të njoftojë zotëruesit e pasurive të sekuestruara për vendimin e marrë prej saj. Po në zbatim të kësaj dispozite, për realizimin e njoftimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile. Duke qënë se gjykata e gjeti kërkesën e paraqitur të drejtë dhe ligjore,

vendimi saj duhet t'i njoftohet si shtetasve nën hetim **A.P** dhe E.GJ, ashtu edhe personave të tretë V.K, F.F, G.P dhe G.B.

Në bazë të pikës 3 të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15 të Ligjit në fjalë kompetentë për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të pasurive janë përmbaruesit gjyqësorë dhe administratorët e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Në këto kushte është detyrim ligjor për gjykatën që në vendimin e saj të urdhërojë zyrën e përmbarimit, në juridiksionin e të cilës ndodhet pasuria e palujtëshme (neni 516 i Kodit të Procedurës Civile) dhe, një administrator të agjensisë, të cilët do të koordinojnë punën për zbatimin e vendimit të sekuestrës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d” dhe pika 2 gërma “b”, nenit 7 pika 1 dhe 2, nenit 11 pika 1 gërma “a”, nenit 12 pika 1 dhe 2, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës.
 - Vendosjen e sekuestrës mbi pasuritë e mëposhtme:
1. Aktivitetit të shoqërisë anonime “**XXX**”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqëri në Shqipëri, shoqëri e cila është regjistruar me datë 03/12/2008, me numër NIPTI KXXXX5U, me datë themelimi 01/12/2008, me adresë në Tiranë, me kapital fillestar 20.000.000 lekë, me objekt “Organizimin e lojërave të fatit sportive-baste sportive”.

2. Aktivitetit të shoqërisë anonime “XXXX”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqëri në Shqipëri, shoqëri e cila është regjistruar me datë 26/02/2010, me numër NIPTI LXXX1B, me datë themelimi 11/02/2010, me adresë në Vlorë, me kapital fillestar 10.000.000 lekë, me objekt: “Administrimi i agjencive për mbledhjen dhe transmetimin e të dhënave me ndihmën e sistemeve informatike dhe të telekomunikacionit, të lidhura ngushtë me prenotimet dhe kontabilizimin të lojërave me ngjarje sportive dhe josportive, subjekte të monopolit të shtetit shqiptar apo të institucioneve të tjera publike shqiptare, të autorizuara për t’u regjistruar në Shqipëri në bazë të ligjeve në fuqi dhe të atyre që do të dalin në të ardhmen në këtë fushë. Administrimin e agjensive për baste të çdo lloji e tipi. Administrimin e llotarive të çastit me çmime dhe llotari fati të mundshme të çdo lloji e tipi. Regjistrim i ngjarjeve sportive në bazë të dispozitave që regullojnë marrjen e licensave dhe autorizimeve në këtë fushë. Hapjen e sallave sportive në formë live-administrimi i sallave për lojëra, kazino elektronike apo live me ndihmën e operatorit etj”.
3. Aktivitetit të shoqërisë anonime “XXXX”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqërie në Shqipëri, shoqëri e cila është regjistruar me datë 01/03/2010, me numër NIPTI LXXXX4D, me datë themelimi 12/02/2010, me kohëzgjatje deri me 12/02/2060, me Seli në Tiranë, me kapital fillestar 20.000.000 lekë, me objekt “Sherbime në software, nëpërmjet internetit, për parashikimin e zhvillimit të lojërave të fatit, të kazinove, basteve, garave të ndryshme të të gjitha llojeve, prodhim i materialeve, lëndëve të para dhe prodhim i makinave elektronike të lojërave të fatit. Zhvillim i lojërave të fatit, lojrat aritmetike, lotot, keno, bingo, proto, xhoker, baste, llotari, lojera elektronike, lojëra fati sportive të cilat janë, konkurs për parashikimet sportive të të gjitha lojrave sportive si ato që luhen me këmbë, me dorë, në ujë, për gjetjen e rezultateve, të ndeshjeve të futbollit, ose lojërave të tjera sportive të të gjitha llojeve, kazino”.

- Për administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive ngarkohen **z.SH.N dhe zj. D.B**, administratore pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

- Për ekzekutimin e këtij vendimi të sekuestros mbi pasuritë dhe aktivitetet tregtare (shoqëritë anonime të identifikuara më lart), ngarkohen Zyrat e Përmbarimit Gjyqësor perkatese, sipas vendndodhjes se pronës, aktivitetit ekonomik per te cilat eshte vendosur masa e sekuestros.

- Urdhërohet K/sekretaria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, t'i njoftojë shtetasve nën hetim **A.P**, E.GJ, si dhe personat e lidhur me to **V.K, F.F, G.P** dhe **G.B**, këtë vendim « për sekuestrimin e pasurive të sipërsënuara ».

- Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit të veçantë, brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë. Për shtetasit **A.P, E.GJ**, si dhe personat e lidhur me to **V.K, F.F, G.P** dhe **G.B**, fillon nga dita e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall sot në Tiranë, në datë 07.10.2010

SEKRETARE
ERMIRA TERBUNI

GJYQ TAR
BARDHYL DHAMA